

**HIV/AIDS NË SHQIPËRI**



**INSTITUTI SHENDETIT PUBLIK , 2022**

## SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE


Informacioni paraqet situatën e infeksionit HIV në Shqipëri, bazuar në të dhënat e mbledhura deri në fund të Tetorit 2022.

Të dhënat ekzistuese dëshmojnë se në Shqipëri nuk ka epidemi të gjeneralizuar apo të përqendruar të infeksionit HIV. Ndërsa numri vjetor i rasteve të raportuara mbeti nën 50 raste deri në vitin 2010, midis vitit 2010 dhe 2022 numri vjetor i rasteve të raportuara me HIV u rrit më shumë se 2 herë nga 48 raste (2008) në 127 raste (4.5 raste/100.000 që ishte niveli më i lartë) në 2016.

Numri i rasteve të reja të diagnostikuara në 2022 është 80, ndërsa referuar të dhënave kumulative, gjatë periudhës 1993-2022, numri total i rasteve të raportuara me HIV/AIDS është 1586.

Në fund të Tetorit 2022, prevalenca e infeksionit vlerësohet të jetë me 0,06%, ndërsa incidenca (rastet e reja në 2022) 2.9 për 100,000 banorë.


**Grafiku 1.** Shpërndarja e rasteve me HIV në vite, 1993- 2022



Rruga seksuale e transmetimit të virusit HIV vazhdon të dominojë në vendin tonë, e cila konstatohet në afërsisht 96% të rasteve. Sipas të dhënave kumulative (deri në Tetor 2022) transmetimi heteroseksual përbën 83.7% të rasteve, ndërkohë që mënyra e transmetimit nëpërmjet marrëdhënieve seksuale midis meshkujve haset në 12.2 % të rasteve .


Transmetimi vertikal ose nga nëna e infektuar me HIV te fëmija përbën 2.5 % të totalit, 0.7% i përkasin rasteve të transmetimit nëpërmjet gjakut apo nënprodukteve të tij; 0.5% e rasteve i përkasin grupit të Personave që Injektojnë Drogë dhe në 0.4 % të numrit total të rasteve pozitive, rruga e transmetimit mbetet e papërcaktuar.

**Grafiku 2.** Shpërndarja e rasteve me HIV sipas rrugës së transmetimit (n=1586).




Ashtu si dhe në vitet e mëparshme, më shumë meshkuj se femra u diagnostikuan me HIV në vitin 2022, duke rezultuar në një raport të përgjithshëm meshkuj-femra prej 3.2:1. Në total (1993-2022), 72 % janë meshkuj dhe 28 % janë femra.

**Grafiku 3.** Shpërndarja e rasteve me HIV sipas gjinisë në vite (2010-2022)



Për vitin 2022, niveli i incidences (rastet e reja të diagnostikuara) te meshkujt është 4.4. për 100.000 dhe për femrat 1.35 për 100.000. Në rastet e diagnostikuar në vitin 2022, numri më i madh konstatohet të meshkujt e grupmoshës >50 vjec, ndërsa te femrat në grupmoshën 30-39 vjec (grafiku 4).

**Grafiku 4.** Rastet e reja (viti 2022) sipas gjinisë dhe grup-moshës



Shpërndarja sipas grupmoshave tregon se në vendin tonë predominon grupmosha 35-44 vjec (29 %), e ndjekur nga grupmosha 25-34 vjec (27%). Grupmosha 45-54 vjeç raportohet 18 %, të rinjtë 16-24 vjec përbëjnë 9%, grm. 55-64 vjec përbën 11 % të totalit të rasteve të infektuara me HIV, ndërsa fëmijët (0-15 vjec) përbëjnë 3%. Një përqindje më të ulët paraqet grupmosha mbi 65 vjec në vlerën 3%.

Mosha mesatare e rasteve të reja të diagnostikuara në 2022 ishte 39 vjeç, dhe është më e lartë te femrat se sa te meshkujt 39.5 dhe 38.5 vjec respektivisht.

Nga rastet e raportuara në vitin 2022, gjysma e rasteve pozitive (50%) vijnë nga klinikat, kryesisht nga Shërbimi i Sëmundjeve Infektive në QSUT; 15% i përkasin testimeve vullnetare që vijnë në shërbimet e keshillimit dhe testimit për HIV (VCT) dhe laboratore privatë; 11.3% nga spitale privatë, 11.3 % nga ndjekja epidemiologjike që kryhet për partnerin/partneren ose për fëmijën e diagnostikuar pozitiv; 3.8% nga testimi i donatoreve të gjakut 3.8 % i përkasin përkatësisht kategorive gra shtatzëna, 2.5% janë diagnostikuar si testime të referuara nga shoqatat që ofrojnë shërbime për popullatat kyç (PK) dhe 2.5 % vijnë pasi janë të konfirmuar nga jashtë vendit.

Diagnoza e hershme është shumë e rëndësishme në ecurinë e infeksionit HIV dhe suksesin e mjekimit me Antiretrovirale (TAR). Diagnostikimi i vonshëm vazhdon të mbetet sërish prezent edhe me numrin e madh të rasteve që raportohen në stadin AIDS. Edhe gjatë vitit 2022, personat e diagnostikuar me HIV kanë patur akses të plotë gjatë gjithë vitit për kryerjen e vlerësimit imunologjik.

Nga rastet e regjistruara për herë të parë pranë klinikës ambulatore në vitin 2022, 93% e tyre kanë kryer testin për matjen e CD4, krahasuar me 88.5% që e kishin kryer në të njëjten periudhë të vitit 2021. Të dhënat tregojnë se 70% e pacientëve të rinj që kanë kryer testin e CD4 kanë paraqitur CD4 më të ulët se 350, çka flet për një diagnozë të vonë të infeksionit HIV, 49% e rasteve që kanë kryer CD4 janë raportuar në një stad shumë të vonë të infeksionit ( $CD4 < 200$ ); 16 % raportohen të kenë një CD4 në vlerat 350-500 dhe 14% raportohen me një  $CD4 > 500$ . Grupi i pacientëve me diagnoze të vonë dhe shume të vonë, mund të kenë qenë të infektuar prej vitesh pa shfaqur simptoma. Por në këto rast duhet patur parasysh se secili person mund të ketë pasur disa partnerë është shumë i rëndësishëm, dhe thekson se rëndësia e infeksionit në fazat e hershme të tij. Bazuar në klasifikimin e CDC-së për AIDS (kriteri klinik dhe imunologjik), 50.7% nga rastet e regjistruara në kujdesin për HIV në vitin 2022 janë në stadin AIDS.

Përqindja e personave që janë regjistruar për herë të parë në kujdes dhe që janë diagnostikuar në një stad të vonë ( $CD4 < 350$ ) varion sipas grupmoshës dhe gjinisë, ku nivelet më të larta vërhen te meshkujt dhe te grupmoshat 50+ vjec dhe ajo 30-39 vjec. Në total numri i personave HIV pozitiv që nuk jetojnë deri në Tetor 2022 është 315.

HIV/AIDS mbetet një fenomen akoma urban në vendin tonë pasi shumica e personave janë me vendbanim në qytet. Numri më i madh i rasteve ose 47.8 % e tyre janë raportuar në Tiranë, më

pas me një diferencë të madhe nga Tirana paraqiten rrethe të tilla si Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Lushnjë, Sarandë etj.